



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 130/4 Prot.

Tiranë, më 08 4 2016

REKOMANDIM

Nr. 08 datë 08 04 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ngarkim të klinikës-kontrolluesit, "Genius" me formë ligjore të aktivitetit person juridik, NIPT: K63121801C;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.32, datë 16.02.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, si më lart cituar, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Genius" sh.p.k., të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Gjatë kryerjes së veprimeve administrative procedurale, në datat 16.02.2016 e vazhdim, pranë këtij kontrolluesi, grupi i kontrollit ka konstatuar:

Kontrolluesi "Genius" sh.p.k. ka një vit që operon në fushën e mjekësisë laboratorike;

1. Nuk ishte kryer njoftimi nga ana e kontrolluesit, detyrim të cilin e përmbushi në datë 23.02.2016;
2. Kontrolluesi nuk kishte rregullat tipike të shkruara për mbrojtjen e të dhënave personale, por në kontratën me punëmarrësin ka rregulla strikte, ku i bashkangjit deklaratën e konfidencialitetit, dhe drafti i procesit të akreditimit për mbrojtjen e të dhënave të pacientëve, mbi sigurinë e këtyre të dhënave në sistemin elektronik ishte në përputhje me standartet e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;
3. Informonte subjektet e të dhënave për përpunimin e tyre nëpërmjet sistemit CCTV, por në formularët tip që pacientët plotësojnë, konstatohet se nuk ishte parashikuar informimi, si dhe rubrika për marrjen e pëlqimit të pacientit;
4. Në marrëdhëniet kontraktuale me palë të treta, kontrolluesi kishte parashikuar në parim, paragrafe konfidencialiteti me palën, por mbetet e paplotë për sa i përket, mbrojtjes së të dhënave personale.

Në datën 05.04.2016, nga Zyra e Komisionerit është realizuar seanca dëgjimore mbi ezaurimin e së drejtës të palëve për tu dëgjuar, konform nenit 93 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar, ku kontrolluesi “Genius” sh.p.k., paraqiti pjesën më të madhe të dokumentacionit të plotësuar, sipas gjetjeve të mësipërme konstatuar nga grupi i hetimit administrativ, përveç pikës 4 për të cilën kontrolluesi u shpreh së është në proces të hartimit të aneks kontratave me palët e treta, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit vlerëson faktin që, kontrolluesi “Genius” sh.p.k., edhe pse në fillimet e aktivitetit të tij, gjatë kontrollit nga grupi i hetimit administrativ ka qënë bashkëpunues, serioz reagues në lidhje me zbatimin e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip, në rastet e këtij delegimi”, kontrolluesi “Genius” sh.p.k.. të hartojë aneks kontratat sipas standarteve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve – pacientë.
2. Kontrolluesi, detyrimin rekomandues të dalë nga ky akt i Komisionerit, duhet ta realizojë brenda një afati kohor, prej 30 ditësh.
3. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 08 .4 .2016

